



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0642-A0001

**Në çështjen juridike të:**

**Paditësi/ankuesi**

**H A-** i përfaqësuar nga avokati Dr.sc. R M K Prishtinë.

**Kundër:**

**E paditura**

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP),** Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit të parashtruar kundër Aktvendimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-13-1379, të datës 11 nëntor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-13 -1379, i datës 11 nëntor 2022.**
- 3. Shkalla e parë e DHPGJS, duhet ta trajtoj parashtresën e dt. 29 nëntor 2022.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedure ankimore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 24 korrik 2013, paditësi parashtror ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN 127-0016 të datës 04 korrik 2013, me të cilin i ishte refuzuar si e pafshme kërkesa për kompensim për paga të pa paguara, në shumë prej 28,755.00

euro, për periudhën kohore nga viti 1997 deri më 15 mars 2006, nga NSH "Ekonomia Peshkatore" (në likuidim).

Më 25 tetor 2017, e paditura parashtror mbrojtje në ankesë, në të cilën ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar.

Më 12 tetor 2022, gjykata lëshoj për paditësin vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar paditësin, se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr, mirëpo në fletë dërgesë nga ana e zyrtarit të postës është konstatuar se pala ankuese "ka vdekur".

Më 11 nëntor 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së, me Aktvendimin C-IV.-13-1379, në piken 1 Procedurën në këtë çështje juridike e ka ndërprerë për shkak të vdekjes së paditësit H A dhe në piken 2 Procedura do të vazhdohet kur trashëgimatrët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin, apo kujdestari i tij kërkon vazhdimin e procedurës, apo kur gjykata në bazë të propozimit të palës së kundërt kërkon që palët të vazhdojnë procedurën. Në arsyetim të vendimit thuhet sipas dispozitës 277 pika (a) të LPK-së "procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqësore vdes ose e humb zotësinë procedural, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokure në gjykim; Në vazhdim, dispozita e nenit 280 par.1 të LPK-së parashesh: procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)-d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasuris trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare. Shkalla e I-rë ka konstatuar se me dt. 12 tetor 2022, Gjykata ka tentuar që paditësit t'ia dërgojë vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e parashtruar, por nga ana e zyrtarit të postës është konstatuar se pala "ka vdekur", andaj meqë pala paditëse ka vdekur për këtë arsye ka vendosur që ta ndërprerës procedurën.

Më 29 nëntor 2022, përfaqësuesi i pasardhësve të paditësit ka parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJSK-së, kundër aktvendimit të Shkallës së I-rë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Përfaqësuesi i kundërshton të gjitha konstatimet e Shkallës së parë dhe i konsideron ato si konstatime të gabuara dhe të pa drejta. I ka propozuar Kolegjit të Apelit që ta aprovojë ankesën e paditësit si të bazuar, si dhe lënda të kthehet në rigjykim aty ku ka mbetur. Tutje konsideron se Shkalla e I-rë ka marrë Aktvendim të pa drejtë me të cilin ndërpritet procedura juridike duke u bazuar në konstatimin e zyrtarit të postës

se pala " ka vdekur", e që një aktvendim i tillë duke mos u mbështetur në asnjë prove përkatëse siç është certifikata e vdekjes apo verifikim i këtij fakti në librin amë të vdekurve pranë Komunës përkatëse pa dyshim që ka sjellë një vendim të kundërligjshëm dhe me shkelje të dispozitave duke mos vërtetuar gjendjen faktike sipas dispozitave përkatëse për faktin se akti i vdekjes është dëshmia e vetme ligjore në të cilën mund të mbështetet vendimin e saj Gjykata.

Thekson se Shkalla I-rë ka bërë shkelje të nenit 280 par.1 të LPK-së ku përcaktohet se procedura që është ndërprerë për shkak të nenit 277, do të vazhdohet mes tjerash kur thërret Gjykata ta bëjnë këtë e që në rastin konkret pas vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore, konstatohet se ekziston interesi i trashëgimtarëve për të vazhduar këtë procedure sepse të njëjtit qysh me datën 04.11.2022 kanë bërë pagesën e taksës gjyqësore mirëpo përkundër kësaj prove ku qartë është shprehur gatishmeria e trashëgimtarëve për të marrë përsipër procedurën përkundër kësaj gatishmërie gjykata më datë 11 nëntor 2022 e ndërpret procedurën duke mos ju dhënë mundësi trashëgimtarëve për vazhdimin e saj e në këtë mënyrë duke shkaktuar zvarritje të procedurës të pa nevojshme. Trashëgimtarët e ankuesit kanë shprehur interes dhe gatishmëri për marrje përsipër të procesit, kjo dëshmohet me faktin se me të pranuar vërejtjen për takes gjyqësore me të cilën edhe janë njoftuar veç se po fillon shqyrtimi lidhur me këtë lëndë, të njëjtit pa vonesë kanë paguar taksën gjyqësore e po ashtu kanë parashtruar parashtresë për precizimin subjektiv të ankesës me kërkesë për vazhdimin e procedurës, andaj në mbështetje të Nenit 204 të LPK-së, i autorizuari i trashëgimtarëve të ankuesit tani i ndjerë H A, kërkon nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që t'i vlerësoj thënët në ankesë, te aprovohet ankesa si e bazuar dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe të vazhdohet procedura aty ku ka mbetur. Ankesës i ka bashkangjitur autorizimin për përfaqësim të dhen nga Sh, Xh, dhe V A, dëshmi vdekjen dt. 23 dhjetor 2020, , Certifikatën e vdekjes për H A, një kapje të pagesës së taksës gjyqësore dt. 04 nëntor 2022, kopjet e letërnjoftimeve për Sh, Xh, dhe V A, një parashtresë të dt. 29 nëntor 2022, drejtuar DHPGJS me të cilën përfaqësuesi i autorizuarave ka bërë precizimin subjektiv të ankesës me numër C-IV.-13-1379, të datës 24 korrik 2013 dhe kërkesës për vazhdimin e procedurës, duke kërkuara nga DHPGJS që të aprovohet propozimi për vazhdimin e procedurës së ndërprerë në lëndën C-IV.-13-1379.

Më 12 dhjetor 2023, Kolegji i Apelit këtë ankesë i'a ka dërguar të paditurës për përgjigje.

Në përgjigjen e datës 20 dhjetor 2023, e paditura i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit/ankuesit dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj. E paditura në përgjigjen në ankesën thekson se aktvendimi i shkallës së parë të DHPGJSK-së është i bazuar në ligj e prova dhe si i tillë ai duhet të konfirmohet (lihet në fuqi nga Kolegji i Ankesave). E paditura në mbrojtjen e saj lidhur me argumentet e ankesës thekson se është qartësisht dhe mjaftueshmërisht i sqaruar në mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktvendimin me C-IV.-13-1379 nga DHPGJSK-ja, pranë Shkallës së parë. Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtarë i propozon kolegjit të Ankesave që t'i referohet Mbrojtjes dhe Aktgjykimit përkatës.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 10.9 të Ligjit nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) dhe nenit 60.2 dhe nenit 64.1 të Shtojcës, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet .

Kolegji i Apelit vëren se tani i ndjeri paditësi H A kishte dorëzuar kërkesë me datë 19 maj 2006 pranë Autoritetit të Likuidimit (AL) për kompensim për paga të pa paguara shumë prej 28,755.00 euro, për periudhën nga viti 1997 deri më 15 mars 2006, nga N.SH "Ekonomia e Peshkatarisë" ( në Likuidim), por që AL e kishte refuzuar kërkesën e tij si të pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se tani i ndjeri H A me dt. 22 korrik 2013, kishte parashtruar ankesë në DHPGJS, kundër vendimi të AL, ndërsa me Aktvendimin C-IV.-13-1379, të dt. 11 nëntor 2022, Shkallës së I-rë të DHPGJS-së në piken 1 Procedurën në këtë çështje juridike e ka ndërprerë për shkak të vdekjes së paditësit H A dhe në piken 2

ka shënuar se Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e saj. Ndërprerjen e procedurës, nga Shkalla e I-rë ishte bërë pasi që me rastin e dërgimit të vërejtjes për ta paguara taksën gjyqësore nga ana e zyrtarit të postës ishte konstatuar se pala 'ka vdekur' (ishte fjala për paditësin).

Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e I-rë drejtë ka aplikuar dispozitën e nenit 277 pika (a) të LPK-së ku shprehimisht theksohet se "procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humb zotësinë procedural, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim; Në vazhdim, dispozita e nenit 280 par.1 të LPK-së parasheh se: procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)-d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtarë.

Pra shkalla e I-rë në kohën e vendosjes përpos informatës se paditësi H A ishte i vdekur nuk ka pasur ndonjë informate tjetër për trashëgimtarët tjerë të cilët janë paraqitur në procedurë të ankesës për ta vazhduar procedurën, prandaj Aktvendimi i shkallës së parë konsiderohet i drejtë.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë në piken 2 të dispozitivit të Aktvendimit C-IV.-13-1379, me të drejtë ka shënuar se Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e saj. Pra trashëgimtarët është dashur që fillimisht të dorëzojnë kërkesës për vazhdimin e procedurës nga DHPGJS, në lëndën C-IV.-13-1379, meqë siç kemi cekur më lart procedura ishte ndërprerë deri sa të paraqiten trashëgimtarët e paditësit. Trashëgimtarët e paditësit me provat të cilat i kanë bashkangjitur me ankesë siç janë: autorizimi për përfaqësim të dhen nga Sh, Xh, dhe V A, dëshmi vdekja dt. 23 dhjetor 2020, Certifikata e vdekjes për paditësin H A, kopjet e letërnjoftimeve për Sh, Xh, dhe V A, janë dëshmi të mjaftueshëm për ta vazhduara procedurën e ndërprerë në Shkallë të I-rë në lëndën C-IV.-13-1379, por nuk mund të pranohen si prova në procedurë të ankesës për ta konsideruar Aktvendimin e Shkallës së I-rë si të pa drejtë dhe të paligjshëm, meqë siç arsyetua më lart këto dëshmi nuk janë paraqitur në shkallën e parë.

Kolegji i Apelit vëren se përfaqësuesi trashëgimtareve të paditësit përmes parashtresës së dt. 29 nëntor 2022, ka bërë precizimin subjektiv të ankesës me numër C-IV.-13-1379, të datës 24 korrik 2013 dhe kërkesës për vazhdimin e procedurës, ashtu që ka kërkuara nga DHPGJS që të aprovohet propozimi për vazhdimin e

procedurës së ndërprerë në lëndën C-IV.-13-1379, por siç duket nga shkresat e lëndës kjo parashtresë nuk është futur në dosjen e shkalles së pare. Megjithatë Kolegji i Apelit vlerëson se trashëgimtarët e të ndjerit H A ashtu siç është shënuar në piken 2 të dispozitivit të Aktvendimit të Shkallës së I-rë mund të paraqesin kërkesë për vazhdimin e procedurës së ndërprerë në Shkallë të I-rë në lëndën C-IV.-13-1379.

Pretendimet e përfaqësuesit të trashëgimtareve të paditësit të paraqitura me ankesë në Kolegjin e Apelit se Shkalla e I-rë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga 182 i LPK-së sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit, nuk janë të themelta, kjo për shkak se Shkalla e I-rë e DHPGJS ka zbatuara drejtë dhe saktë dispozitat e LPK-së duke e ndërprerë procedurën Gjyqësorë dhe duke i dhen mundësi palëve që procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e saj.

Nga këto arsye, ankesa të autorizuarit të trashëgimtarëve të paditësit është e pabazuar, dhe është vërtetuar Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

### **Taksat gjyqësore**

Taksat gjyqësore janë paguar konform nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ankuesi nuk ngarkohen me taksë gjyqësore shtesë.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 07 mars 2024.

Mr.Sc, Sahit Sylejmani Gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_